

Ministria e Shtetit Bavarez për Mjedis dhe Mbrojtje të Konsumatorit



Fletë-informacion për myslimanët:

Rregullat në Bavari për therjet për nder të festës Islame të Kurban-Bajramit

- Ndalojeni therjet e kafshëve në shtëpi apo në natyrë.
- Transporti i kafshëve mund të bëhet vetëm me kamion të përshtatshëm transporti (p.sh. rimorkio). P.sh. ndalohet transporti në bagazhin e veturës.
- Kafshët duhen trajtuar mirë. Nuk lejohen tërheqja zvarrë e lesshit, të ulurit mbi kafshë, mbajtja apo lidhja e këmbëve të tyre, apo veprime të ngjashme. Sepse nga trajtimet e tillë nuk vuajnë vetëm kafshët por humbet edhe cilësia e mishit.
- Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Kafshëve, kafsha mund të theret vetëm nën ndikimin e **anestezionit**. Ndalohet gjakderdhja (therja) e kafshës pa narkozë. Institucioni përkatës mund të lëshojë leje vetëm në raste të caktuara.
- Ju mund të kryeni therjen vetëm nëse posedoni certifikatën e kompetencës. Lidhur me këtë mund të informoheni në entin përkatës të veterinarisë.
- Përndryshe ju mund ta përcillni kafshën e flijimit gjatë therjes duke e vendosur dorën tuaj mbi të dhe duke u lutur përderisa therja të kryhet nga persona kompetentë.
- **E rëndësishme gjatë therjes:** ndalojeni prerje të panevojshme, si dhe lakimi i qafës deri në thyerje. Koka mund të hiqet vetëm pas vdekjes së kafshës.
- Ju mund të hyni në vendin përkatës për therje vetëm pas konsultimit me udhëheqësin e saj. Parakusht për këtë janë **rroba të pastra mbrojtëse** (p.sh. ato për një përdorim) dhe **pastrimi e dezinfekti i duarve si dhe mbathjeve**. Në rast se ju lejoheni të merrni pjesë gjatë copëtimit të mishit, atëherë vetëm nëse paraprakisht jeni **trajnuar sipas Ligjit të Mbrojtjes kundër Infeksioneve**. Për këtë është përgjegjëse Ministria e Shëndetësisë.
- **Kontrollimi zyrtar i kafshës së therur dhe i mishit është i detyrueshëm.** Veterinari zyrtar kontrollon shëndetin e kafshës dhe konfirmon nëse duhet të hiqen dhe hidhen pjesë/organe të kafshës. Shëndeti i kafshës vërtetohet me vulosjen e mishit me ngjyrë për artikuj ushqimore. Vetëm atëherë ju mund ta merrni mishin.
- Pjesë të caktuara të mishit dhe organe (të ashtuquajturat materialet e rrezikshme) nuk mund të merren dhe duhet të asgjësohen. Bëhet fjalë për shembull për shpretkën dhe pjesën e fundit të zorrës së hollë (ileum) tek delet dhe dhitë e secilës moshe. Tek gjedhet, delet dhe dhitë mbi moshën 12 vjeçare bëjnë pjesë në grupin e këtyre organeve p.sh. truri, kafka dhe sytë.
- Stomaku dhe zorrët mund te merren pas pastrimit dhe zbrazjes së tyre nga makineria. Kokat mund të jepen nga thertorja vetëm pasi u është hequr lëkura dhe nëse janë nga kafshët mbi moshën 12 muajsh.
- Për transportimin e mishit për në shtëpi duhet të pajiseni me mbajtës të përshtatshëm për transport, p.sh. me mbajtës të pastër të plastikës. Në stinën e verës preferohet që transporti të bëhet me kuti ftohëse.
- Në rast se keni pyetje të tjera apo ju duhen informata shtesë lidhur me trajnime apo shkollime mund t'i drejtoheni entit përkatës të veterinarisë (Administrata e Qytetit apo Komuna).